



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0474**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Kimete Gashi-Brajshori, dhe Vedat Poterqoi -Anëtar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) CAPITAL X FET SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KOMUNA E GJAKOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirërmajtja e objekteve-pastrimi i objekteve te KPSH-së dhe QPS-së, me numër të prokurimit 632-23-11804-2-1-1, me 05.08.2024, mori:

## **Vendim**

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE CAPITAL X FET SH.P.K. me nr. 2024/0474 , e datës 31.05.2024, kurse vendimi i AK- KOMUNA E GJAKOVËS lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirërmajtja e objekteve-pastrimi i objekteve te KPSH-së dhe QPS-së me numër të prokurimit 632-23-11804-2-1-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik CAPITAL X FET SH.P.K.

## Arsyetim

### *- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me 09.11.2023, Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Ndërsa me datën 13.05.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë “GOE PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË; Pastrime Silvio Sh.P.K.”

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratë kornizë me një operator, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 530,089.50 euro.

Me 20.05.2024, OE Capital X Fet Sh.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 23.05.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 31.05.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Capital X Fet Sh.P.K., me numër protokollit 474/24 lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirërmajtja e objekteve-pastrimi i objekteve të KPSH-së dhe QPS-së me numër të prokurimit 632-23-11804-2-1-1.

### *-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Capital X Fet Sh.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimet e Operatorit Ekonomik : Në lidhje me ankesën e OE ankues, OE ka paraqitur një numër të madh të argumenteve dhe fakteve që mbështesin pretendimet se vendimi i AK për të shpallur PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË; Pastrime Silvio Sh.P.K. si fitues është i pa drejtë dhe se kjo kompani nuk plotëson kriteret e dosjes së tenderit. Bazuar në analizën e OE ankues, ka disa pika kyçe që mund të përfshihen në ankesën tuaj në mënyrë të strukturuar dhe bindëse:

Mungesa e dokumentacionit dhe përmbushja e kriterëve teknike:

PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË ka dorëzuar Aneksin 6 me dy projekte që nuk përputhen me kriteret e kontratave të ngjashme siç kërkohet nga dosja e tenderit.

Pastrime Silvio Sh.P.K. nuk ka paraqitur kontrata të mjaftueshme në 3 vitet e fundit në vlerën e kërkuar prej 795,000.00 euro për kontrata të ngjashme.

Cënim i kriterit të liderit të konsorciumit:

PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË ka paraqitur veten si lider i grupit, por nuk ka paraqitur dëshmi se ka të paktën 51% të kontratave të ngjashme, duke e bërë atë të pa përputhshme me kriteret e dosjes së tenderit.

Mosplotësimi i kriterëve financiarë dhe administrativë:

Pastrime Silvio Sh.P.K. nuk ka plotësuar Specifikimet Teknike siç është kërkuar në Aneksin 1 të dosjes së tenderit, duke mos llogaritur pagën e menaxherit dhe duke ofruar një çmim që nuk i përmirëson të gjitha shpenzimet e nevojshme për përfundimin e projektit.

Vlerësimi i ofertës dhe analizës financiare:

Analiza e ofertës së Pastrime Silvio Sh.P.K. tregon mos përputhje në detajet financiare dhe nuk ka përfunduar me kujdes aspektet administrative, duke lënë hapësirë për gabime dhe mosplotësimin e kriterëve të përcaktuara në dosjen e tenderit.

Pajtueshmëria me Ligjin e Prokurimit Publik:

Ankesa e OE ankues argumenton se vendimi i AK ka shkelur disa pika të Ligjit të Prokurimit Publik, duke përfshirë shkelje të parimeve të ekonomisë, efikasitetit, barazisë në trajtim dhe ekzaminimit dhe vlerësimin të tenderëve.

Duke u referuar kërkesave si më sipër Capital X Fet Sh.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenet Neni 1, Neni 6, Neni 7, Neni 59, dhe Neni 60.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim: Pretendimi juaj i parë nuk qëndron, sepse ky Grup i Operatorëve Ekonomik ka dorëzuar marrëveshjen për formimin e konzorciumit ku lider caktohet Pastrime Silvio sh.p.k. Nuk është e domosdoshme që lideri i grupit të dorëzojë dosjen e tenderit. Lideri i grupit është caktuar nëpërmjet marrëveshjes për bashkëpunim-konzorcium dhe jo sipas renditjes së emrave të anëtarëve të GOE të shënuar në dorëzimin e ofertës.

Pretendimi juaj i dytë, gjithashtu nuk qëndron, sepse lideri i grupit nuk është PE-VLA-KU sh.p.k.-Dega në Kosovë, por Pastrime Silvio sh.p.k., gjë që dëshmohet me marrëveshjen për bashkëpunim-konzorcium.

Pretendimi se Pastrime Silvio sh.p.k. shumicën e kontratave me vlerë të madhe i ka me afat të skaduar nuk qëndron, sepse në Fjalorin e Termave dhe Njoftimin për kontratë kërkohet dorëzimi i kontratave të realizuara në tre vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë që është më 09.11.2023. Kontratat e paraqitura nga ky operator janë brenda këtij afati.

Pretendimi lidhur me anëtarësinë e dy anëtarëve të grupit nuk qëndron, sepse të dy anëtarët e grupit kanë deklaruar se do të përmbushin specifikimet teknike të detyrueshme.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i prokurimit me datë 21.06.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë

shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 474/2024, ndërsa me datë 27.06.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/474 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për kontrat dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim”.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet lidhur me rekomandimin e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me mendimin e ekspertit .

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

#### ***- Administrimi dhe vlerësimi i provave –***

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Capital X Fet Sh.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/474 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i ekspertit shqyrtues në këtë përgjigje të ekspertit shqyrtues përkatësisht për çdo pretendim të OE (Operatorit Ekonomik) ankues, janë analizuar dhe vlerësuar argumentet dhe prova të paraqitura në ankim. Për të përmirësuar qartësinë dhe të kuptuarit e situatës, këtu është një përmlledhje e përgjigjeve të ekspertit për secilin pretendim të OE:

#### **Konstatimi i parë (I):**

Kontratat janë vlerësuar të jenë brenda afatit të kërkuar me dosjen e tenderit.

Projekteve të papërfunduara u është mohuar përfshirja në vlerësimin përfundimtar.

Kontratat për rindërtim janë vlerësuar të përshtaten me kriteret e natyrës së ngjashme.

#### **Konstatimi i dytë (II):**

Marrëveshja e konsorciumit dhe caktimi i liderit është vlerësuar si i përputhshëm me UOPP.

#### **Konstatimi i tretë (III):**

Kërkesat për përshtatshmërinë profesionale nuk janë kërkuar në dosjen e tenderit.

#### **Konstatimi i katërt (IV):**

Kontratat janë vlerësuar për përmbushjen e kriterëve të dosjes së tenderit.

Kontratat që nuk kanë përfunduar ose janë jashtë afatit janë mospranuar në vlerësim.

**Konstatimi i pestë (V):**

Specifikimet teknike nuk kërkohen të jenë të nënshkruara dhe të vulosura në FDT.

Pretendimi është shqyrtuar si i pavlefshëm për këtë arsye.

**Konstatimi i gjashtë (VI):**

Analiza financiare e dorëzuar nuk përfshin pagën e menaxherit për mbikëqyrjen e punës, duke shkelur kriteret e kërkuara në Aneksin 6.

**Konstatimi i shtatë (VII):**

Lista e kontratave të realizuara ka përfshirë vetëm ato të përfunduara dhe të përputhura me kriteret e FDT.

Referenca e dorëzuar në emër të GOE është pranuar si valide dhe e përputhur me ligjin.

**Konstatimi i tetë (VIII):**

Nënshkrimi i specifikimeve teknike nuk është kërkuar specifikisht në FDT.

**Konstatimi i nentë (IX):**

Analiza financiare e dorëzuar nuk përfshin pagën e menaxherit, duke shkelur kriteret e Aneksit 6.

Në përgjigjet e tij, eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes të gjitha pretendimet dhe ka dhënë vlerësime të detajuara për secilin prej tyre bazuar në kriteret dhe dokumentacionin e dorëzuar në dosjen e tenderit. Këto përgjigje janë të orientuara drejt argumentimit se si dhe pse ka përcaktuar mospranimin ose pranimin e secilit pretendim të OE ankues.

***- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -***

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e Mirërmajtja e objekteve-pastrimi i objekteve të KPSH-së dhe QPS-së me numër të prokurimit 632-23-11804-2-1-1. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues Capital X Fet Sh.P.K., dhe se Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues Capital X Fet Sh.P.K., janë të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve

ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me Mirërmajtja e objekteve-pastrimi i objekteve të KPSH-së dhe QPS-së me numër të prokurimit 632-23-11804-2-1-1, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Batisha Ibrahimi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - CAPITAL X FET SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: